



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivery	02-06-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednitsa Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	3209/2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.406/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.406/2022 të datës 21.04.2020 e parashtruar përmes postes elektronike ankesa,KPMSHCK@rks-gov.net nga ankuesi

me adresë: kundër organit të punësimit Komunës së Klinës, në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.406/2022, e datës 21.04.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokolli 111-9982/22 i datës 29.03.2022 për publikimin e përfundimit të procedurës së rivlerësimit dhe shpalljen e rezultateve finale

A r s y e t i m

Komuna e Klinës, sipas njoftimit datës 28.01.2022 ka publikuar konkursin e jashtëm për grupin „Specialist të Arkivit-Dokumentacionit” për pozitën „Zyrtar i Depos 3”, me numër reference RN00008270 për afatin për aplikim nga data 18.02.2022 deri me datë 25.02.2022, pasi që konkursi për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00008015, i datës 29.12.2021 nuk ka rezultuar me sukses, sepse nuk ka aplikuar asnjë kandidat, andaj me njoftimin me numër Nr.111-2377/22 të datës 21.01.2022, Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Komunë të Klinës e ka përfunduar procedurën e brendshme.

Ankuesi ka aplikuar në konkursin me numër referencë RN00008270, me emrin e grupit „Specialist të Arkivit-Dokumentacionit” për pozitën „Zyrtar i Depos 3”, në Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport, e shpallur nga Komuna e Klinës sipas njoftimit datës 28.01.2022 për

aplikim nga data 18.02.2022 deri me datë 25.02.2022, në të cilën procedurë ankuesi ka qenë i përfshirë deri në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit.

Me datë 22.03.2022 përmes Njoftimit me numër protokoll 112-9210 është njoftuar nga Menaxheri i Personelit të Komunës së Klinës, se lidhur me vlerësimin e testit me shkrim dhe vlerësimit të jetëshkrimit nuk ka arritur të grumbullojë së paku 60 pikë, në dy hapat e para të vlerësimit gjegjësisht nuk ka arritur pikët e duhura për të plotësuar kushtin për të vazhduar konkurrimin e mëtejshëm për intervistë me gojë, respektivisht ankuesi në total ka arritur të grumbullojë gjithsej 52 pikë.

Po ashtu, me datë 22.03.2022 Komuna e Klinës, gjegjësisht Udhëheqësi i Zyrës së Personelit ka publikuar njoftimin me numër protokoll 112-9208/2022 për përfundimin e procedurës së vlerësimit dhe shpalljen e rezultateve për pozitën "Zyrtar i deposë-3", me numër reference RN00008270/RPC0002066.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 22.03.2022 ka parashtruar ankesë përmes sistemit elektronike HRMS me datë 24.03.2022 tek Komisioni i Pranimit në Komunën e Klinës. Komisioni i pranimit me datë 28.03.2022 ka nxjerrë Vendim me numër protokoll 111-9909/22 me të cilin e ka njoftuar ankuesin lidhur me vlerësim të jetëshkrimit, gjegjësisht e ka njoftuar që ankuesi në total prej 20 pikëve ka arritur vetëm 10 pikë.

Me datë 29.03.2022 Zyra e Personelit e Komunës së Klinës ka publikuar Vendimin me numër 112-9982/22 për përfundimin e procedurës pas rivlerësimit nga Komisioni për Pranim dhe ka shpallur rezultatet finale për pozitën "Zyrtar i deposë-3", me numër reference RN00008270/RPC0002066.

Ankuesi me datë 20.04.2022 ka parashtruar ankesë përmes sistemit elektronik e-mailit për ankesa ankesa.kpmschck@rks-gov.net, e pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.04.2022 dhe e regjistruar me numër protokoll 2278/2022, me pretendime ankimore për mos respektimin e dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit të datës 18.02.2022, sepse tek rasti i vlerësimit të tij, nuk është kërkuar përvoja e punës, dhe në fazën e vlerësimit të CV-së ose jetëshkrimit është vlerësuar për përvojë të punës dhe trajnime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.04.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klinës, ndërsa Këshilli me datë 12.05.2022 ka pranuar dokumentacionin e bashkangjitur nga Komuna e Klinës, po ashtu lidhur me këtë përgjigje Këshilli ka kërkuar prova shtesë me datë 27.05.2022 për shkak të mungesës së tyre, ndërsa Komuna e Klinës për mes e-mailit zyrtar ka dërguar provat shtesë me datë 27.05.2020 dhe 31.05.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën Anr.406/2022 me numër protokoll 2278/2022 e datës 21.04.2022 e parashtruar përmes e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, të datës 20.04.2022i në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të bashkangjitur dhe formularin për regjistrimin e ankesës së KPMSHCK-së; Kërkesa për përgjigje në ankesën e ankuesit e datës 29.04.2022 nga KPMSHCK; Përgjigje në ankesë e datës 12.05.2022 nga K. Klinës me nr. protokoll 2738/2022; Kërkesë për fillimin e procedurës së rekrutimit të jashtëm e datës 27.01.2022; Konkursi i datës

28.01.2022; Njoftimi i datës 28.02.2022 mbi vlerësimin paraprak; Vendimi i komisionit pranues për zhvillimin e procedurës së rekrutimit; E-mail i datës 10.03.2022; Pasqyra e kandidatëve që kanë marrë pjesë në testim me shkrim e nxjerr nga sistemi elektronik; Njoftimi i datës 22.03.2022 me numër 112-9982/22 për përfundimin e procedurës së rivlerësimit nga komisioni për pranim ka shpallur rezultatet finale për pozitën "Zyrtar i Depos 3"; Njoftim i datës 22.03.2022 për ankuesin lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit; Ankesë nga sistemi elektronik; Vendim-përgjigje në ankesë e datës 28.03.2022; Kërkesa e datës 24.12.2021 për fillimin e lëvizjes së brendshme, me Konkursin e datës 29.12.2021, Njoftimi i datës 21.01.2022 për përfundim të procedurës për lëvizje të brendshme; shkresë e datës 10.05.2022; Prova shtesë përmes e-mailit të datës 27.05.2022, sipas kërkesës së datës 27.05.2022; **Aplikacioni i A.G**, me CV si në vijim: Diplomë e datës 04.05.2021 nr.25/21 lëshuar nga Kolegji "Dardania", në Prishtinë Bachelor i Arteve në Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane; Certifikatë e datës 15.05.2018; Certifikatë e datës 19.07.2017; **Aplikacioni i B.SH**, me CV si në vijim: Diplomë e datës 30.11.2019 nr.6811 lëshuar nga Kolegji "Dardania", në Prishtinë Juriste i diplomuar - Bachelor; Letër reference e datës 21.05.2021; Certifikatë qershor i vitit 2018; **Aplikacioni i F.M**, me CV, si në vijim: Diplomë e datës 04.02.2021 nr.1608 lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", Fakulteti Filozofik në Prishtinë, vërtetim me numër LRP.nr.3370/2021; **Aplikacioni i I.A**, me CV, si në vijim: Diplomë e datës 21.04.2019 lëshuar nga shkolla: "Fehmi Agani" në Klinë, për kryerjen e shkollës së mesme të lartë profesionale, me numër protokollit 01-36/19, Vërtetim Noterial i datës 22.02.2022 me numër LRP.Nr.1266/2022; letër reference lëshuar nga D.PT. "Troja", e vitit 2015; **Aplikacioni i J.M**, me CV, si në vijim: Diplomë e datës 12.0.2016 nr.6658, lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", Fakulteti Ekonomik në Prishtinë, Referencë e datës 03.11.2017; Certifikatë e datës 08.07.2017; vërtetim me numër LRP.nr.3370/2021; Përgjegje e datës 29.04.2022 nga njësia e personelit për ankesën e ankuesit; Lista e aplikacioneve e nxjerre nga sistemi elektronik-SIMBNJ; Renditja përfundimtare e kandidatëve e nxjerrë nga sistemi elektronik SIMBNJ; E-mail, Njoftim i datës 10.03.2022 për mbajtjen e testit me shkrim. Kërkesa për prova shtese përmes e-maili të datës 27.05.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Përgjigjja e Komuna e Klinës për mes e-mailit me te cilin ka dërguar provat shtese të datës 27.05.2020 dhe 31.05.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar së ankesa e parashtruar nga ankuesi **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka gjetur se Komuna e Klinës, sipas njoftimit të datës 28.01.2022 ka publikuar konkursin e jashtëm për grupin „Specialist të Arkivit-Dokumentacionit“ për pozitën „Zyrtar i Depos 3“, me numër reference RN00008270 për afatin për aplikim nga data 18.02.2022 deri me datë 25.02.2022, pasi që konkursi për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00008015, i datës 29.12.2021 nuk ka rezultuar me sukses, sepse nuk ka aplikuar asnjë kandidat, andaj me njoftimin me numër Nr.111-2377/22 të datës 21.01.2022, Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Komunë të Klinës e ka përfunduar procedurën e brendshme. Komuna e Klinës konkursin e jashtëm për grupin „Specialist të Arkivit-Dokumentacionit“ për pozitën „Zyrtar i Depos 3“, me numër reference RN00008270 e ka shpallur duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesi [redacted] ka aplikuar në konkursin me numër referencë RN00008270, me emrin e grupit „Specialist të Arkiv-it-Dokumentacionit” për pozitën „Zyrtar i Depos 3”, në Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport, e shpallur nga Komuna e Klinës sipas njoftimit datës 28.01.2022 për aplikim nga data 18.02.2022 deri me datë 25.02.2022, në të cilën procedurë ankuesi ka qenë i përfshirë deri në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit.

Sipas konkursit me numër reference RN00008270, sipas njoftimit të datës 28/01/2022, i shpallur me datë 18.02.2022, për grupin „Specialist të Arkiv-it-Dokumentacionit” për pozitën „Zyrtar i Depos 3”, në Komunën e Klinës, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- Diplomë/a e shkollës së mesme apo ekuivalente me to,
- Përvoja e punës nuk është kërkuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar nëntë (9) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përzgjedhur nëntë (9) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi i cili e ka kaluar fazën e verifikimit dhe ka marrë pjesë në testin me shkrim por pas testit me shkrim, nuk është përzgjedhur nga Komisioni i Pranimit për te vazhduar me tej me intervistën me gojë sepse sipas Vendimit me numër protokoll 111-9909/22 të datës 28.03.2022 ankuesi lidhur me jetëshkrimin është vlerësuar, si në vijim: *tetë (8) pikë për shkollim, një (1) pikë përvoja e punës dhe një (1) pikë trajnimet, në total për jetëshkrimin ka marrë 10 pikë ndërsa në test me shkrim ka marrë 42 pike, andaj në dy këto faza ankuesi ka grumbulluar në total 52 pikë, gjegjësisht sipas Komisionit të Pranimit ankuesi nuk ka pasur mbi 60 pikë siç është e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku thuhet se: “ Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë në dy hapat e para të vlerësimit, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë”.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit i janë dhënë pikë në përvojën e punës dhe trajnimeve, që nuk janë kërkuar në kriteret e konkursit, pasi që në testin me shkrim ankuesi është vlerësuar me 42 pikë dhe në vlerësimin e jetëshkrimit me 10 pikë ku gjithsejtë i ka arritur 52 pikë të përgjithshme dhe nuk ka arritur që të vazhdojë fazën në intervistë me gojë, duke pretenduar se komisioni i pranimit nuk i ka bërë vlerësimin real dhe te drejtë të jetëshkrimit në raport me kandidatët e tjerë, sepse Komisioni e ka vlerësuar me pike për përvojën e punës dhe trajnimet të cilat në konkurs nuk janë kërkuar.

Kolegji, lidhur me pretendimet e lartpërmendur të ankuesit, pasi ka administruar provat e lëndës ka konstatuar se organi i punësimit me date 31.05.2022 përmes e-mailit zyrtar të dorëzuar në Këshillin e Përvarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ka përcjella prova shtesë konkretisht Vendimin mbi korrigjimin teknik të pikëve të jetëshkrimit në Vendimin - përgjigjejen me numër protokoll 111-9909/22 të 28.03.2022,, respektivisht ka korrigjuar vlerësimin e jetëshkrimit për ankuesin tek pikët e përvojës së punës dhe të trajnimeve, duke vepruar në pajtim me nenin 50 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Organi publik, në çdo kohë, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës, mund të korrigjojë gabimet drejtshkrimore, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të ngjashme, të dukshme, në një akt administrativ”. Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në rastin konkret Komisioni i Pranimit ka bërë korrigjimin e aktit administrativ në kohën kur e ka kuptuar se është lëshuar gabimi, duke korrigjuar gabimin teknik lidhur me pikët e përvojës së punës dhe

te trajnimeve për vlerësimin e jetëshkrimit për ankuesin, duke arsyetuar se ankuesit është dashur ti vendosen 8 pikët të përgjithshme nga jetëshkrimi, e jo 10 pikë, sepse nuk ka prezantuar dëshmi për përvojën e punës dhe dëshmi apo certifikata për trajnimet të kryera sepse nuk janë kërkuar në konkurs, andaj nga kjo rrjedhë se edhe vlerësimi i pikëve të përgjithshme sipas Njoftimit me numër të protokollit 112-9210/22 të datës 22.03.2022 duhet të jete gjithsejtë 50 pikë nga 52 siç kanë qenë para korrigjimit të Vendimit.

Lidhur me këtë Kolegji ka konstatuar se Komisioni i Pranimit, me rastin nxjerrjes së Vendimit të datës 31.05.2022 mbi korrigjimin teknik të pikëve të jetëshkrimit në Vendimin – përgjigjejen me numër protokollit 111-9909/22 të 28.03.2022, ka bërë vlerësimin përfundimtar të jetëshkrimit në pajtim me nenin 22 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse në rastin konkret ankuesi është vlerësuar me pikët maksimale për shkollim sepse në dosjen e aplikacionit ka dorëzuar vetëm Diplomën e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", ndërsa në përvojë pune dhe trajnime është vlerësuar me 0 pike sepse nuk ka ofruar dëshmi për përvojën e punës dhe dëshmi apo certifikata për trajnimet të kryera sepse nuk janë kërkuar në konkurs. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka analizuar provat e lartpërmendura dhe ka konstatuar se përmirësimi i pikëve të vlerësimit nga Komisioni i Pranimit ka qenë vlerësim i drejtë dhe se nuk ka pasur gabime tjera në vlerësim dhe si rrjedhojë e kësaj pretendimet ankimore të ankuesit për favorizim të kandidatëve të përzgjedhur janë të pabazuara sepse përmirësimi i vlerësimit për dy pikë nuk ka ndikuar në rezultatin përfundimtar dhe në renditjen e kandidatëve në listën e përzgjedhur.

Kolegji, po ashtu ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës me datë 22.03.2022 ka publikuar Vendimin me numër protokollit 112-9208/2022 lidhur me përfundimin e procedurës së rekrutimit për grupin *Specialist të Arkivit-Dokumentacionit* për pozitën „Zyrtar i Depos 3“, duke listuar lidhur me rezultatet përfundimtare katër kandidatet me mbi 70 pikët e arritura, ndërsa si kandidatë e suksesshme është përzgjedhur _____ që ka arritur gjithsejtë 81.40 pikët e përgjithshme, andaj Kolegji konstaton se publikimi është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është theksuar se: **2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues.**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar des, mite e ofruara ka konstatuar se Komisioni i Pranimit me rastin e përzgjedhjes së kandidatës _____ për grupin *Specialist të Arkivit-Dokumentacionit* për pozitën „Zyrtar i Depos 3“, në Komunën e Klinës si kandidatja e cila ka grumbulluar me së shumti pikë gjithsejtë 81.40 pikët e përgjithshme, ka vepruar në pajtim me nenin 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: „... nenin 24. **Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në se cilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit**“, ndërsa sa i përket vlerësimit të arsimimit kandidatja e përzgjedhur posedon Diplomë me numër 6811 të datë 29.01.2020, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës „Hasan Prishtina“ me të cilin dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin Juridik me date 30.11.2019 dhe ka marr titullin Juriste e diplomuar -Bachelor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Zyra e Personelit e Komunës së Klinës me rastin e nxjerrjes së Vendimi me numër protokollit 112-9208/2022 të datës 22.03.2022 dhe Vendimit me numër protokollit 111-9982/22 të datës 29.03.2022 për përfundimin e

procedurës së rivlerësimit dhe shpalljen e rezultateve finale për pozitën për pozitën "Zyrtar i deposë-3", me numër reference RN00008270/RPC0002066, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe nenin 25 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Po ashtu Komisioni i pranimit me rastin nxjerrjes së Vendimit të datës 31.05.2022 mbi korrigjimin teknik të pikëve të jetëshkrimit në Vendimin - përgjigjejen me numër protokoll 111-9909/22 të 28.03.2022, ka bërë vlerësimin përfundimtar të jetëshkrimit në pajtim me nenin 22 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me nenin 50 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative,

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se procedura e konkursit sipas njoftimit të datës 28/01/2022, i shpallur me datë 18.02.2022, për grupin „Specialist të Arkivit-Dokumentacionit“ për pozitën „Zyrtar i Depos 3“, në Komunën e Klinës, me numër reference RN00008270 është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.406/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Klinës:
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunë të Klinës,
- Arkivit të KPMSHCK-së.